

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurit **M.B.**, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5383/15, të dt.13.06.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.II.nr.5383/15, të dt.13.06.2016, më dt.**29.05.2017**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5383/15, të dt.13.06.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri: M.B., nga i ati A., i lindur me *data e lindjes...*, nga Gj., rr. "...” pn, i pa martuar ka të kryer shkollën e mesme, student, me gjendje të mesme ekonomike, me nr. personal *numer pesonal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e:

Me datë 08.09.2015 rreth orës 02:40, në Prishtinë në rrugën "Agim Ramadani" nga qendra e qytetit në drejtim të spitalit përballë "Qendrës së Studenteve", deri sa i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e tipit "O. A.", ngjyrë e bardhë me targa të regjistrimit *numri i targave...* nga pakujdesia duke menduar lehtë se në atë mënyrë nuk do të rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, në kundërshtim me nenin 42 të LSKRR-së, duke mos përshtatur kushteve të rrugës dhe kufizimit të shpejtësisë me shenja të komunikacionit, humb kontrollin mbi drejtimin dhe me pjesën e përparme të automjetit në këmbën e djathtë ka goditur punëtorin-këmbësorin tani të dëmtuarin V.F. i cili ishte duke punuar rrugën, me ç'rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumën prej **40.88 €** dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari V.F., nga P., rr. “...” p.n, me nr.tel: *numri telefonit...*, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.5383/15, të dt.13.06.2016, e ka akuzuar **M.B.**, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal nr. 2015-AR-2227, i datës 08.09.2015, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit inxh. Xh.P., e dt. 08.01.2016, si dhe ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. F.D. e dt. 07.06.2016, dhe foto dokumentacioni dhe në skicën nga vendi i ngjarjes, me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Pas vlerësimit me shumë kujdes të gjitha provave materiale të lartcekura, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë nga: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit inxh. Xh.P, e dt. 08.01.2016, është konstatuar se deri te aksidentit i trafikut ka ardhur për shkak të lëshimeve nga ana e të pandehurit, në këtë rast i njëjti duke mos përshtatur shpejtësinë e automjetit, e ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit me ç’rast me pjesën e përparme të automjetit e ka goditur këmbësin-punëtorin në këmbën e djathtë, i cili në atë moment ka qenë duke punuar në rrugën, dhe në këtë mënyrë ka ardhur deri te aksidenti i trafikut në komunikacion me lëndime trupore dhe dëme materiale.

Në bazë të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.D. e dt. 07.06.2016 për të dëmtuarit, lidhur me natyrën dhe shkallen e lëndimeve trupore konstatohet se i dëmtuari V.F. ka pësuar ndrydhje të indeve të buta të kokës, të regjionit të gjurit të këmbës së djathtë, plagë çarse-shqyrëse të indeve të buta të regjionit ballor të anës së majtë të kokës dhe me gërvishjet lëkurore dhe përdredhje të indeve të buta të qafës, të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri P.S, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.2788/16, i dt.29.05.2017

Zyrtari Ligjor
Leutrim Hoti

Gjyqtarja,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimet të tij, në këtë gjykatë.